



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Zhvillimit Urban
MINISTRI

URDHËR

Nr. 159 datë 12/10/2015.

**"PËR
MIRATIMIN E FORMULARËVE TIP TË PRANIMIT TË PROJEKTEVE"**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 107/2014, datë 03.07.2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të Udhëzimit nr. 3, datë 08.10.2015, "Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme të zbatimit të programit të banesave me kosto të ulët për komunitetin Rom dhe Egjiptian", me qëllim evidentimin e saktë të gjendjes së projekteve për përmirësimin e kushteve të strehimit, të depozituara në Ministrinë e Zhvillimit Urban (MZHU) nga bashkitë,

URDHËROJ

1. Miratimin e formularëve tip 1 dhe 2 të pranimi të projekteve, bashkëlidhur këtij urdhri, si më poshtë:
 - Formulari nr. 1 "Formular i aplikimit të projektit", i cili plotësohet nga Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe dorëzohet nga përfaqësuesi i autorizuar i njësisë pranë Sektorit të Infrastrukturës në Drejtorinë e Zhvillimit Urban dhe Strehimit.
 - Formulari nr. 2 "Formular i vlerësimit teknik", i cili plotësohet nga Sektori i Infrastrukturës në Drejtorinë e Zhvillimit Urban dhe Strehimit dhe shërben për vlerësimin nga ana teknike të projekteve të paraqitura në MZHU.
2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Urbane dhe Strehimit për zbatimin e këtij urdhri.
3. Urdhri nr. 2, datë 06.01.2015, "Për miratimin e formularëve tip të pranimi të projekteve", i Ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, shfuqizohet.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

EGHLANTINA GJERMENI
MINISTER



Prot 5366



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Zhvillimit Urban
Drejtoria e Shërbimeve Urbane dhe Strehimit

Nr. _____ prot.

Datë ____/____/201__

FORMULAR I APLIKIMIT TË PROJEKTIT

Bazuar në ligjin nr. 107/2014, datë 03.07.2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, në lidhje me vlerësimin e projekteve, sot më datë ____/____/201__, pranë Drejtorisë së Shërbimeve Urbane dhe Strehimit, u paraqit: Bashkia _____ e përfaqësuar nga z./znj. _____ në cilësinë e _____ sjell për miratim projektin e objektit:

“ _____ ”

i cili përbëhet nga dokumentacioni si më poshtë:

- | | |
|---|--------------------------|
| 1- Projekti i plotë | ☐ |
| 2- Relacion teknik | ☐ |
| 3- Specifikime teknike | ☐ |
| 4- Fotografi të objektit | ☐ |
| 5- Leje Ndërtimi (në raste të ndërtimeve të reja) | ☐ |
| 6- Preventivi i objektit me vlerë _____ | ☐ |
| 7- Të dhëna të veçanta të objektit | ☐ |

Marrësi në dorëzim

Përfaqësuesi

Specialisti _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Zhvillimit Urban
Drejtoria e Shërbimeve Urbane dhe Strehimit

FORMULAR I VLERËSIMIT TEKNIK

“Mbi plotësimin e dosjes të paraqitur pranë Drejtorisë të Shërbimeve Urbane dhe Strehimit”, për objektin:

BASHKISË _____

Nga vlerësimi që iu bë projektit, rezulton si më poshtë:

Spektori i Infrastrukturës në Drejtorinë e Shërbimeve Urbane dhe Strehimit, pasi bëri të gjitha verifikimet e nevojshme bazuar në Formularin e aplikimit nr. ____ prot, datë ____/____/____, projektin e paraqitur dhe të gjithë dokumentacionin pjesë e praktikës së paraqitur nga _____, lidhur me projektin

vlerëson se projekti i paraqitur plotëson të gjitha kushtet dhe vlerësohet si kandidaturë për të përfituar fondin e parashikuar në buxhet, me vlerë preventivi **të ndryshuar/ të pandryshuar** _____.

Në rast të kundërt, për mungesë dokumentacioni ose përmirësime të nevojshme të projektit, Spektori i Infrastrukturës në Drejtorinë e Shërbimeve Urbane dhe Strehimit vlerëson se:

- Për plotësimin e kushteve të projektimit të objektit,

me qëllim që të realizohet në përputhje me të gjitha rregullat dhe standardet e ndërtimit si dhe të vlerësohet i përshtatshëm për të përfituar fondin e parashikuar në buxhet, nga ana juaj duhet të plotësohen edhe këto dokumente:

- _____
- _____
- _____

Këto dokumente duhet të plotësohen dhe dorëzohen brenda datës ____/____/____.

Për MZHU Tiranë
Drejtoria e Shërbimeve Urbane dhe Strehimit

Tiranë më ____/____/____